



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.60, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 10.7.2017**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.07.2017, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Z. Leonidha Hristo.

OBJEKT: Për mospranimin për shqyrtim kërkesës ankimore Nr.60, datë 10.07.2017, të paraqitur nga kërkues Z. Leonidha Hristo Kandidat i pavarur, me objekt, Shpalljen e pavlefshme te zgjedhjeve në Bashkinë Finiq. për zgjedhjet për organet e qeverisjes Vendore të datës 30.06.2017.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "b" dhe neni 126, pika 2, neni 129 pika 3, germa "b", neni 130 gema "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



Nr. 1082 i Vendimit Data 11.07.2015 Ora 10:00 e Vendimit

Për mospranimin për Shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.60, datë 11.07.2017 të paraqitur nga
Kërkuesi Z.Leonidha Hristo.

V Ë R E N:

Kërkuesi Z. Leonidha Hristo ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr.60 regj, datë 10.07.2017 me relator znj. Edlira Jorgaqi.

Në mbledhjen e datës 11.07.2017, ora 10:00 u diskutua në lidhje me kërkesën ankimore nr. 60 datë 10.07.2017, nëpërmjet të cilës Z. Leonidha Hristo, kandidat i pavarur në bashkinë Finiq kërkon shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në bashkinë Finiq duke kundërshtuar vendimin nr. 96 datë 02.07.2019 të KZAZ-së 89 u konstatua paraqitja e kësaj kërkesë jashtë afatit ligjor.

KQZ, referuar nenit 129 të Kodit Zgjedhor bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore, në lidhje me elementet e formës të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor si dhe verifikon elementet e mëposhtme të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor:

- a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitimin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

Neni 124, pika 1 dhe 2, përcakton se çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqesin ankim në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Referuar nenit 124 të Kodit Zgjedhor, ankimi i paraqitur nga kandidati z. Leonidha Hristo, më datë 10.07.2019, kundër vendimit të KZAZ-së nr. 89, të datës 2.07.2019, është jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh.

Ankuesi ka paraqitur edhe një shkresë e cila mban datën 02.07.2019, protokolluar me 05.07.2019. Nëpërmjet kësaj shkresë kandidati i pavarur shpreh disa shkelje që janë vërejtur gjatë procesit të votimit dhe për këto shkelje kërkon hetim administrativ.

Kërkesa e datës 2.7.2019 në të cilën ankuesi kërkon një hetim administrative klasifikohet si një rast denoncimi dhe nuk përmbush kërkesat e parashikuara në nenin 124, pika 1 dhe 2 dhe nenin 126 pika b,c,d,dh të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në lidhje me ankimet zgjedhore.

Në këto kushte kërkesa ankimore nr. 60 nuk i plotëson elementët e parashikuara në nenin 130 germa c të Kodit Zgjedhor, elementë që lidhen me afatin.

Në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa b, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore nuk duhet të pranohet.



Nr. 1082 i Vendimit

Data 11.07.2015

Ora 10:00 e Vendimit

Për mospranimin për Shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.60, datë 11.07.2017 të paraqitur nga Kërkuesi Z.Leonidha Hristo.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "b" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.60, datë 10.07.2017, të paraqitur nga Z. Leonidha Kristo.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 1082 i Vendimit Data 11.07.2015 Ora 10:00 e Vendimit

Për mospranimin për Shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.60, datë 11.07.2017 të paraqitur nga Kërkuesi Z.Leonidha Hristo.